



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 03.11.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë për mbrojtjen shoqërore”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Dashamir Peza, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Anila Agalliu, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Mhill Fufi, Eduard Halimi, Arben Ristani, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj, Xhemal Qefalia, Gent Strazimiri.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Silva Caka, Fatmir Mediu, Tom Doshi.

Të ftuar:

Astrit Kuka – përfaqësues i Drejtorisë së Pagave dhe Pensioneve në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Astrit Hado – zëvendës drejtor i ISSH-së.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen.

Në rend të ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë për mbrojtjen shoqërore”.

Zotërinjtë Astrit Kuka dhe Astrit Hado, përfaqësues nga ministria dhe nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore janë prezent për të paraqitur dhe mbrojtur projektin.

Kush do të bëjë një përmbledhje të shkurtër? Kjo është një marrëveshje standard, por, gjithsesi, mund të na bëni një prezantim.

Astrit Hado – Faleminderit!

Marrëveshja është përgatitur bazuar në detyrimin që kemi nga marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, e cila, në kuadrin e lëvizjes së lirë të shtetasve, përcakton detyrimin që qeveria shqiptare të marrë masa për koordinimin e skemës së sigurimeve shoqërore.

Kjo marrëveshje është përgatitur bazuar në rregulloren e Komisionit European 883/2004 dhe bazohet në parimet themelore të koordinimit të skemës, që janë parimi i trajtimit të barabartë në punësim e përfitime, garantimi i personave që lëvizin nga një vend në tjetrin për të drejtat e fituara në vendet përkatëse, bashkimi i periudhave të sigurimeve shoqërore dhe e drejta për të eksportuar përfitime.

Marrëveshja ka përfshirë të gjitha degët e sigurimit shoqëror e shëndetësor dhe konkretisht degën e sëmundjes për personat e punësuar, barrë lindje për personat e punësuar dhe të punësuarve për punëdhënësit, aksidente në punë dhe sëmundje profesionale për personat e punësuar, pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe familjar.

Gjithashtu, ka përfshirë edhe përfitime nga skema e detyrueshme e sigurimeve shëndetësore. Kjo marrëveshje është në vazhden e shumë marrëveshjeve të tjera, duke ndjekur të njëjtat parime.

Për informacion, në këtë moment që flasim janë 10 marrëveshje të ratifikuara dhe në zbatim kemi marrëveshjen me Turqinë, Belgjikën dhe Luksemburgun, e cila u ratifikua para disa muajsh, në prill të këtij viti. Janë miratuar nga qeveria dhe nënshkruar nga ministri marrëveshjet me Maqedoninë, Hungarinë, Rumaninë, Çekinë dhe Gjermaninë. Këto janë nënshkruar dhe i janë përcjellë Ministrisë së Jashtme nga ana jonë për ratifikim. Ndërkohë, marrëveshja me Kanadanë është e përfunduar, pritet nënshkrimi nga ministri, u miratua në parim nga Këshilli i Ministrave. Ndërsa marrëveshja me Austrinë javën e ardhshme është raundi i fundit i bisedimeve dhe përfundon.

Për ratifikim, krahas kësaj marrëveshjeje që ka ardhur, këto ditë do të vijnë edhe marrëveshjet e tjera me Hungarinë, Çekinë, Rumaninë dhe Gjermaninë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zonja Agalliu, në cilësinë e relatores.

Anila Agalliu- Faleminderit, zoti Hado, për sqarimin e dhënë!

Komisioni ynë e shqyrton këtë projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë për mbrojtjen shoqërore” dhe është komision për dhënie mendimi.

Projektligji është bazuar në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1 të Kushtetutës. Miratimi i këtij projektligji i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm për sa i përket shumicës.

Marrëveshja konsiston në ofrimin e përfitimeve në sigurimet shoqërore dhe bazohet në parimin e trajtimit të barabartë të punëtorëve në punësim, trajtimin me përfitime dhe të ardhura, si dhe rregullat koordinuese garantojnë që personat që lëvizin nga një vend në tjetrin dhe personat në varësi të tyre dhe të mbijetuarit të ruajnë të drejtat e fituara apo që janë duke i fituar.

Për të siguruar të drejtën e përfitimeve dhe llogaritjen e tyre merret në konsideratë bashkimi i periudhave të siguruara sipas legjislacioneve kombëtare të ndryshme.

Në aspektin ligjor vlerësoj se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Si relatore, vlerësoj rëndësinë e miratimit të këtij projektligji dhe u kërkoj kolegëve ta miratojmë atë në komision e më pas ta shqyrtojmë në seancë plenare.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Ka pyetje? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka diskutime?

Kush është dakord?

Neni 1.

Anila Agalliu – Në nenin 1, propozoj që fjalët “ratifikimi i marrëveshjes” të zëvendësohen me fjalët “ratifikohet marrëveshja”.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Jeni dakord me nenin 1 me ndryshimin e propozuar?

Dakord.

Neni 2? Dakord.

Kush është dakord në tërësi? Dakord.

Miratohet.

E mbyllim këtu mbledhjen.

Punë të mbarë

MBLEDHJA MBYLLET